

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PEJES**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	635-26-957-1-1-1
Nr i brendshëm	635/26/008/111

Sa i përket tenderit për: “Furnizim me barna dhe material shpenzues mjekësorë për barnatoren qendrore të QKMF-se”.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“MEDPLUS SH.P.K.”

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Pranvera e Lirisë, p.n., Lebanë

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38344640420

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Jeton Prenaj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)


medplusk@gmail.com

(Adresa elektronike)

20.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 04.03.2026 Data e hapjes së ofertave: 04.03.2026 Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 05.06.2026 Kërkesa për rishqyrtim dt:10.06.2026 Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 11.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Neni 41 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik
Neni 14 i LIGJ PËR ÇMIMIN E PRODUKTEVE MEDICINALE.

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilin bazë të ankesës tuaj.

Me dt.05.06.2026 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, kurse ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si më poshtë:

ARSYETIM PËR ELIMINIM – ÇMIM ABNORMALISHT I ULËT DHE MOSPËRPUTHSHMËRI ME SPECIFIKIMET TEKNIKE

Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, Komisioni i Vlerësimit ka shqyrtuar ofertën e Operatorit Ekonomik në përputhje me nenin 6.1.4 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar), të cilat rregullojnë trajtimin e ofertave me çmime abnormalisht të ulëta.

1. Vlerësimi i ofertës financiare – çmim abnormalisht i ulët

Pas analizimit të ofertës financiare, është konstatuar se Operatori Ekonomik ka ofertuar çmime dukshëm më të ulëta krahasuar me vlerën e parashikuar dhe strukturën e çmimeve të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Konkretisht, për 69 pozicionet e paramasës dhe parallogarisë, vlera e përlllogaritur nga Autoriteti Kontraktues është **556.22 €**, ndërsa oferta e dorëzuar nga Operatori Ekonomik është 120.42 €. Kjo paraqet një devijim prej **435.80 €**, përkatësisht rreth **78.37%** më të ulët se vlera e parashikuar..

Diferenca e konsiderueshme ndërmjet vlerës së parashikuar dhe ofertës së paraqitur përbën devijim të theksuar nga nivelet e pritshme të tregut dhe ngre dyshime serioze lidhur me realizueshmërinë e kontratës, aftësinë për furnizim sipas specifikimeve të kërkuara dhe mbulimin e kostove reale të tregut.

Komisioni Vlerësues ka analizuar çmimet për secilin pozicion dhe ka konstatuar se në të gjitha pozicionet, çmimet e ofruara janë dukshëm më të ulëta se çmimet referuese të tregut për produkte me karakteristika të njëjta ose të ngjashme. Rrjedhimisht, këto çmime nuk reflektojnë një strukturë reale ekonomike të kostove të furnizimit.

Për rrjedhojë, Komisioni Vlerësues vlerëson se oferta përmban çmime abnormalisht të ulëta, të cilat nuk janë të justifikuara në përputhje me nenin 61.1 të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Bazuar në këto gjetje, oferta e Operatorit Ekonomik konsiderohet e papërgjegjshme dhe refuzohet.

2. Vlerësimi teknik – mosplotësim i specifikimeve (Pozicioni 68)

Autoriteti Kontraktues, gjatë fazës së vlerësimit teknik të ofertave dhe mostrave të dorëzuara, ka shqyrtuar produktin e ofruar nga Operatori Ekonomik për pozicionin 68, në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Për pozicionin 68 është kërkuar furnizimi me dezinfektues për duar, ku në 100 g tretësirë duhet të përmbahen së paku 89.1 g Etanol 96% si përbërës aktiv. Në Dosjen e Tenderit është përcaktuar qartë se këto specifikime përbëjnë kërkesat minimale të pranueshmërisë dhe çdo produkt duhet t'i plotësojë ato ose t'i tejkalojë.

Nga shqyrtimi i mostrës së dorëzuar dhe dokumentacionit teknik përkatës, është konstatuar se Operatori Ekonomik ka ofertuar produktin "AHD 2000 G – Hygienic and Surgical Hand Disinfectant", i cili sipas etiketës dhe të dhënave të prodhuesit përmban 75 g etanol në 100 g produkt, përkatësisht 75%.

Krahasimi i drejtpërdrejtë ndërmjet specifikimit të kërkuar dhe produktit të ofruar tregon qartë se përmbajtja e etanolit është dukshëm më e ulët se minimumi i kërkuar prej 89.1 g/100 g.

Duke qenë se kërkesa teknike përbën kusht minimal dhe detyrues për pranueshmërinë e ofertës, çdo devijim nën këtë nivel konsiderohet mospërputhje materiale me specifikimet teknike të Dosjes së Tenderit. Në rastin konkret, produkti i ofruar nuk përmbush kërkesën minimale dhe nuk paraqet as specifikim ekuivalent apo më të avancuar.

Përmbajtja e etanolit është element thelbësor për efektivitetin e produktit dezinfektues, dhe mosplotësimi i këtij kriteri përbën devijim substancial nga kërkesat teknike të përcaktuara.

Në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe Dosjen e Tenderit, oferta e Operatorit Ekonomik për pozicionin 68 nuk i përmbush kërkesat minimale teknike dhe konsiderohet ofertë e papërgjegjshme.

Përfundim

Bazuar në të gjitha gjetjet e mësipërme, si në aspektin financiar (çmim abnormalisht i ulët) ashtu edhe në aspektin teknik (mosplotësim i specifikimeve minimale), oferta e Operatorit Ekonomik refuzohet në tërësi si ofertë e papërgjegjshme.

Ju sqarohet se arsyetimi i AK-së për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm dhe i pa bazuar, dhe kundërshtimin e eliminimit e argumentojmë me faktet si në vijim:

1. Arsyeja e parë e eliminimit se kemi ofruar dukshëm çmime më të ulëta në krahasim me vlerën e parashikuar është i pa argumentuar, pasi që ne kemi ofertuar fillimisht brenda vlerës së parashikuar dhe me çmime të cilat janë brenda kornizës së LIGJIT PËR ÇMIMIN E PRODUKTEVE MEDICINALE. Në dispozitën e nenit 14 të këtij ligji paragrafi 1 specifikohet qartë si në vijim: 1. Bazë për përcaktimin e çmimit të blerjes apo të rimbursimit të produkteve medicinale nga ana e institucioneve publike sipas kompetencës përkatëse për kontraktim të produkteve medicinale do të jetë lista zyrtare e çmimeve me shumicë të produkteve medicinale e publikuar nga Ministria.

Ne kemi ofertuar me çmime që janë brenda parashikimeve të listës zyrtare të çmimeve, prandaj arsyeja e eliminimit është plotësisht në kundërshtim me Ligjin Për Çmimin e Produkteve Medicinale e po ashtu edhe me nenin 61 të LPP-së.

Sa i përket realizueshmërisë së kontratës me këto çmime, e që AK-së thekson se ka dyshime, sqarojmë se nëse ka pasur dyshime AK-së, atëherë ka mundur të kërkojë një siguri shtesë siç është rritja e sigurimit të ekzekutimit të kontratës edhe pse autoriteti kontraktues nuk ka argumentuar në asnjë mënyrë arsyen e eliminimit. Si dëshmi që kompania jonë është serioze dhe do të përfundoj kontratën, është edhe kontrata paraprake të cilën e kemi realizuar me autoritetin kontraktues, me përkushtim maksimal dhe në përputhje me kushtet e kontratës. Ne, jemi të sigurt dhe të bindur që mund të realizojmë kontratën me këto çmime dhe jemi në gjendje të argumentojmë mënyrën e realizimit dhe të garantojmë në çfarëdo forme dhe mënyre realizueshmërinë e kësaj kontrate.

Autoriteti kontraktues nuk ka respektuar dispozitën e nenit 61.1 të LPP-së, pasi që nuk ka kërkuar sqarime fare për çmimet e ofruara nga ne, ndërsa në këtë dispozitë përcaktohet që nëse një tender duket me çmime jo normalisht të ulëta autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafín 2. të këtij neni.

Pra, autoriteti kontraktues nuk ka zbatuar procedurën ligjore që përcaktohet për çmime jonormalisht të ulëta, prandaj ka vepruar kundërligjshëm kur na ka eliminu nga konkurrenca, madje ka vepruar në mënyrë arbitrare sepse nuk mund të eliminohet një operator ekonomik pa kërku sqarime.

2. Arsyeja e dytë e eliminimit se kemi ofruar me produktin “AHD 2000 G-Hygienic and Surgical Hand Disinfectant, e që në bazë të etiketës dhe të dhënave të prodhuesit përmban 75 g Etanol në 100g produkt përkatësisht 75 %, sqarojmë se ne kemi ofertuar me produkt ekuivalent, ndërsa ekuivalencën për këtë produkt e ka lejuar edhe paneli shqyrtues me vendimin Nr.186/26 të dt.21.04.2026.

Paneli shqyrtues lidhur me pozicioni 68, konstaton se Autoriteti kontraktues duhet te lejoj ekuivalencen per produktin në ket pozicion dhe të permisohej kjo pike ne DT, sipas arsytimit te ekspertit teknik “sa i përket kërkesës për produktin dezinfektues për duar, bazuar në përshkrimin e specifikimeve teknike në DT, rezulton se produkti i kërkuar nuk përmban një dezinfektues klasik. Por, përbërësit e përfshirë, gjithashtu konzervuesi dhe lëndë ndihmëse posedojne kryesisht veti antifungale dhe japin një efekt të lehtë antibakterial që kontribuojnë në largimin mekanik të papastërtive dhe mikroorganizmave nga lëkura gjatë procesit të larjes duke rezultuar në një efekt indirekt higjienizues. Në këtë kontekst, bazuar në përshkrimin teknik dhe karakteristikat funksionale e mikrobiologjike, produkti i kërkuar i përgjigjet më tepër një shamponi/larësi për duar. Duke marrë parasysh se AK përmes vendimit për rishqyrtim, nuk ka lejuar aplikimin e parimit të ekuivalencës për funksion të njëjtë klinik parim ky që do të mundësonte ofertimin e produkteve teknikisht të përafërta për aq kohë sa përmbushin të njëjtin funksion.Për rrjedhojë, pretendimi ankimor lidhur me këtë pozicion vlerësohet si i bazuar.”

Pretendimi i AK-së se produkti i ofruar nuk përmbush kërkesën minimale dhe nuk paraqet specifikim ekuivalent apo më të avancuar është pretendim i pa qëndrueshëm dhe i pa argumentuar, ndërsa ne e konfirmojmë dhe e argumentojmë ekuivalencën edhe përmes ekspertizës së ekspertit gjyqësor -Farmacist-Specialist i Toksikologjisë dhe Barnave z. Nardi Sh. Sheqerxhiu, të cilin e kemi angazhuar të përgatit ekspertizën, pas pranimit të letrës standarde për tenderues të eliminuar, i cili ka analizuar kërkesat dhe specifikat për produktin Nr.68 të dosjes së tenderit duke krahasuar me specifikat që ne kemi ofruar për këtë produkt. Eksperti profesional gjyqësor në ekspertizën e dt.08.06.2026, ka konstatuar si më poshtë:

DISKUTIM

- A. Subjekti ofertues për pozicionin Nr.68 ka ofruar produktin AHD 2000 1L Dezinfektues për duar ku 100 g tretësirë përmban: 75 g Ethanol 96%.

MENDIM -PËRGJIGJE NË PYETJET

- I. Produkti AHD 2000 1L dhe produkti i kërkuar në pozicionin 68 kanë substancë kimike të njejtë por me përqendrime të ndyshme dhe të dy produktet përdoren si dizinfektues.
- II. Produkti i ofruar për pozicionin Nr.68 mund të konsiderohet i barazvlefshëm në aspektin teknik dhe përdorues ngase qëllimi kryesor është dizinfektimi dhe produkti e posedon atë veti.
- III. Dallimet në përbërje më sakt i përqendrimit të alkoolit produkti i ofruar ka veti dezinfektuese si dhe në aspektin dermatologjik është më i pranueshëm e kjo paraqitet si përparsi.

Bashkangjitur keni ekspertizën në fjalë.

Nga kjo ekspertizë profesionale, kuptohet se produkti i ofruar nga ne është i barazvlefshëm/ekuivalent në aspektin teknik dhe përdorues me produktin e kërkuar, prandaj nga kjo ekspertizë rezulton se ne jemi eliminuar pa të drejtë nga ky aktivitet i prokurimit, kështu që kërkojmë që të korrigjohet ky vlerësim dhe të rekomandohemi për kontratë.

Nuk është e saktë shkencërisht se një përmbajtje më e lartë e etanolit automatikisht nënkupton efektivitet më të lartë dezinfektues.

Arsyetimi i Autoritetit kontraktues se produkti i ofertuar me 75 g etanol/100 g nuk paraqet specifikim ekuivalent apo më të avancuar në raport me kërkesën 89.1 g etanol/100 g, duke arsyetuar se përmbajtja e etanolit është element thelbësor për efektivitetin e produktit dezinfektues, është arsyetim i pa argumentuar dhe i pa mbështetur në evidencë shkencore dhe nuk demonstroi në asnjë mënyrë se koncentrimi 89.1 g/100 g siguron efektivitet superior ndaj produktit të ofertuar me 75 g/100 g.

Përveç ekspertizës që ne e kemi bashkangjitur, edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) WHO rekomandon formulime me 60-80% etanol për dezinfektim.

Bashkangjitur keni udhërrëfyesin e OBSH ne shtesë.

Po ashtu, literatura shkencore konstaton se koncentrimet shumë të larta të alkoolit nuk janë domosdoshmërisht më efektive, pasi prania e ujit është e nevojshme për denaturimin e proteinave mikrobike dhe për rritjen e kohës së kontaktit.

Për rrjedhojë, autoriteti kontraktues nuk ka provuar me asnjë analizë teknike, laboratorike apo referencë shkencore se produkti me 75 g/100 g etanol nuk arrin të njëjtin rezultat dezinfektues ose se është më inferior në performancë ndaj produktit me 89.1 g/100 g etanol. Bashkangjitur keni WHO GUIDELINE ON HAND HYGIENE IN HEALTH CARE (faqe 32 tregon që tretësirat me alkohol 60-80% janë me efektive, dhe koncentrimet me të larta janë më pak potente).

Pra, edhe me ekspertizë e edhe me dëshmitë e lartcekura shkencore dhe në bazë të OBSH, rezulton se produkti ynë me atë përbërje që ka, është edhe më efikas se sa produkti me përbërjen e kërkuar dhe se arsyetimi i AK-së për eliminim tonë është i pa bazuar, i paqëndrueshëm dhe i pa mbështetur në ndonjë provë apo dëshmi shkencore apo në ndonjë ekspertizë profesionale.

- Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në mënyrë tendencioze, me qëllimin e vetëm që të na eliminoj neve nga aktiviteti i prokurimit dhe të anulojë këtë tender, duke e pa se nuk ka arrit të shpërblejë me kontratë OE e favorizuar, pasi që i njëjti ka pasur gabime substanciale duke mos ofruar deklaratën nën betim dhe deklaratën për themelimin e grupit, pra duke qenë administrativisht i papërgjegjshëm.

Grupi i OE të eliminuar “BRT Pharm SHPK&NSHT Neramed ka ofruar çmime tej normalisht të larta dhe mbi çmimin e përcaktuar me Ligjin Për Çmimin e Produkteve Medicinale, pra mbi tavanin e përcaktuar me këtë ligj. Çmimet e përcaktuara me këtë ligj janë çmime të tregut, normalisht të analizuara nga ekspertë dhe hulumtues të çmimeve të tregut të barnave dhe produkteve medicinale.

-P.sh çmimi i alkoolit është ofruar 8 euro ndërsa në treg gjendet rreth 1.50€

-Çmimi i dorëzave është ofruar 7 euro ndërsa në treg gjendet rreth 2.50€

Çmimi për Hyoscine Butylbromide është ofruar mbi çmimin zyrtar të Listës së çmimeve.

-Po ashtu edhe çmimi për Glucose 5% 500ml është ofruar mbi çmimin zyrtar të Listës së çmimeve

Bashkangjitur keni Listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale të ri deklaruara 2026, e ku shihet se grupi i OE “BRT Pharm SHPK&NSHT Neramed, ka ofertuar me çmime mbi tavanin e lejuar me ligjin e lartpërmendur.

Autoriteti kontraktues nuk është dashur të bëjë krahasimin e çmimeve ndërmjet kompanive sepse nuk është krahasim real por krahasimi real është kur çmimi ofertues krahasohet me çmimin e tregut, ndërsa në këtë rast krahasimi më real është kur bëhet krahasimi me çmimin e Listës zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale të rideklaruara 2026.

E kur bëhet ky krahasim, rezulton se ne kemi ofertuar brenda kësaj kornize të çmimeve kurse grupi i OE “BRT Pharm SHPK&NSHT Neramed, ka ofertuar me çmime mbi tavanin e lejuar me ligjin e lartpërmendur, prandaj nga këto dëshmi kuptohet se ne kemi ofertuar me çmime reale me ato të tregut dhe brenda kornizës së çmimeve që i ka përcaktuar Shteti.

Autoriteti kontraktues në vend se të kursejë buxhetin e Shtetit dhe në vend se të stimulojë respektimin e Ligjeve në tërësi duke përfshirë edhe ligjin për Listën zyrtare të çmimeve të produkteve medicinale të rideklaruara 2026, ajo vepron në mënyrë të kundërt duke na eliminuar neve pa bazë ligjore dhe duke e rrezikuar dëmtimin e buxhetit.

Ne me dt.11.05.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, por që në asnjë mënyrë nuk është dhënë asnjë dëshmi konkrete përmes të cilës dëshmohet e kundërta e pretendimeve tona ankimore.

- AK-ja sa i përket pretendimit tonë ankimor në lidhje me arsyen e eliminimit tonë është përgjigj si në vijim:

Lista zyrtare e çmimeve, në kuptim të dispozitës së lartcekur, përcakton tavanin maksimal të çmimit të blerjeve të produkteve medicinale; ajo nuk paraqet as garanci e as dëshmi se një ofertë konkrete është ekonomikisht realizueshme. Përmbushja e tavanit dhe abnormaliteti i çmimit janë dy çështje krejtësisht të ndara: e para ka të bëjë me kufirin e sipërm ligjor të çmimit, ndërsa e dyta me realizueshmërinë e kontratës dhe me mbulimin e kostove reale të furnizimit. Prandaj, fakti që parashtruesi ka mbetur nën tavanin e listës zyrtare nuk e përjashton aspak mundësinë që oferta e tij të jetë abnormalisht e ulët, dhe as nuk e zëvendëson vlerësimin e Autoritetit Kontraktues është i detyruar ta bëjë sipas nenit 61 të LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Në rastin konkret, oferta financiare e parashtruesit prej 120.42 € paraqet një devijim prej rreth 78.37% nën vlerën e parallogaritur prej 556.22 €. Ky devijim i theksuar është konstatuar nga Komisioni Vlerësues jo në mënyrë të përgjithshme, por duke i analizuar çmimet pozicion-për-pozicion dhe duke i krahasuar me çmimet referuese të tregut për produkte me karakteristika të njëjta ose të ngjashme. Një devijim i kësaj përmase ngjyeshme serioze dhe objektive lidhur me aftësinë e operatorit për të furnizuar sipas specifikimeve të kërkuara dhe për të mbuluar kostot reale, gjë që, sipas nenit 61 të LPP-së, i jep Autoritetit Kontraktues të drejtën ta refuzojë ofertën si abnormalisht të ulët.

As propozimi i parashtruesit se Autoriteti Kontraktues mund të kërkonte një siguri shtesë të ekzekutimit nuk ndryshon këtë përfundim. Neni 61 i njejtë Autoritetit Kontraktues të drejtën, e jo detyrimin, që oferta abnormalisht e ulët të refuzohet, dhe asnjë siguri shtesë nuk e shëron mospërputhjen e veçantë teknike që oferta e parashtruesit ka në pozicionin 68. Edhe sikur çështja e çmimit të anashkalohej tërësisht, oferta do të mbetej e papërgjegjshme për shkak të teknike. Po ashtu, referimi në një kontratë të mëparshme të realizuar me Autoritetin Kontraktues nuk ka peshë juridike në këtë procedurë, ngase çdo ofertë vlerësohet vetëm sipas kushteve dhe kriterëve të kësaj Dosjeje të Tenderit.

Kjo përgjigje e AK-së është subjektive dhe pa ndonjë mbështetje ligjore konkrete.

Nuk mund të eliminohet një operator ekonomik me dyshime kinse serioze, siç e paraqet gjendjen autoriteti kontraktues, sepse dyshimet në këtë rast janë tepër subjektive dhe pa ndonjë argumentim faktik e ligjor.

Autoriteti kontraktues nuk ka shpreh fare interesim për të kërkuar sqarime ashtu siç e detyron neni 61 i LPP-së dhe neni 41 i RRPP Nr.001/2022, mirëpo autoriteti kontraktues e supozon dhe e imagjnon sipas dëshirës së tyre aftësinë tonë për kryerjen e kësaj kontrate, e ky veprim i AK-së është veprim arbitrar dhe tendencioz.

Nga ana e autoritetit kontraktues ka një interpretim të gabuar, të njëanshëm dhe subjektiv të nenit 61 të LPP-së, sepse kjo dispozitë nuk e lejon që të eliminohet një OE për çmime jo normalisht të ulëta **pa kërkuar sqarime shtesë**, ndërsa veprimet e AK-së janë në kundërshtim me këtë dispozitë.

Në lidhje me pretendimin Nr.2, AK-së ka dhënë këtë përgjigje:

Dosja e Tenderit, e korrigjuar pikërisht në zbatim të vendimit të OSHP-së nr. 2026/0186 përmes Formularit B54 të datës 23.04.2026, përcakton për pozicionin 68 së paku 89.1 g Etanol 96% në 100 g tretësisë si kërkesë minimale të pranueshmërisë. Shënimi se specifikat janë minimale dhe se mund të ofrohet me specifikacion më të mirë nuk e zbut, por e forcon këtë kufi: ai do të thotë se operatori mund të ofrojë një produkt ekuivalent ose superior, me kusht që ai ta përmbushë ose ta tejkalojë minimumin e përcaktuar. Një përmbajtje prej 75 g në 100 g qëndron nën këtë minimum dhe, për vetë natyrën e saj, nuk mund të konsiderohet as ekuivalente, as më e avancuar se kërkesa, ngase është sasiisht më e ulët se ajo.

Ligjshmëria e këtij specifikimi është tashmë çështje e gjykuar. Parashtruesi i ka kontestuar dy herë kërkesat teknike për pozicionet 68 dhe 69: së pari me ankesën nr. 2026/0186, e cila u aprovua pjesërisht dhe e detyroi Autoritetin Kontraktues të lejojë ekuivalencën, detyrim të cilin Autoriteti e zbatoi me korrigjimin e Dosjes; dhe më pas me ankesën nr. 2026/0284, ku pretendoi se përcaktimi i vlerës 89.1 g favorizon një prodhues të caktuar. Me vendimin nr. 2026/0284, Paneli Shqyrtues i OSHP-së e refuzoi këtë ankesë si të pabazuar, duke konfirmuar se Autoriteti Kontraktues e kishte zbatuar vendimin paraprak dhe se specifikat janë minimale e lejojnë ofertimin me produkt ekuivalent ose më të avancuar. Ky vendim është përfundimtar. Rrjedhimisht, parashtruesi nuk mund ta rihapë në fazën e vlerësimit ligjshmërinë e një specifikimi që dështoi ta përmbushë, e aq më pak të kërkojë që Autoriteti Kontraktues të pranojë një produkt nën minimumin e konfirmuar nga vetë OSHP-ja.

Sa i përket ekspertizës së pavarur dhe referencës në udhërrëfyesin e OBSH-së, ato nuk e ndryshojnë gjendjen faktike e as juridike. Pavarësisht përmbajtjes së tyre, asnjëra prej tyre nuk e vërteton elementin vendimtar – se produkti i ofruar e përmbush kërkesën minimale prej 89.1 g Etanol 96% në 100 g të fiksuar në Dosjen e Tenderit. Specifika e kërkuar nuk plotësohet, dhe Autoriteti Kontraktues nuk mund të dalë jashtë kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe të konfirmuara me vendimin e OSHP-së. Përveç kësaj, neni 40 i Rregullores për Prokurimin Publik ndalon shprehimisht ndryshimin, modifikimin apo heqjen e kriterëve të përcaktuara paraprakisht gjatë vlerësimit; pranimi i një produkti nën 89.1 g/100 g do të përbënte ndryshim të paligjshëm të kriterit dhe trajtim jo të barabartë ndaj operatorëve të tjerë.

Edhe nga kjo përgjigje, kuptohet se AK-së ka analizuar vetëm numrat dhe sasinë por jo përmbajtjen dhe përbërjen e produktit Nr.68 dhe nuk ka marr parasysh ekuivalencën. Gjithashtu nuk ka marr parasysh ekspertizën e ekspertit gjyqësor e as argumentimet shkencore që i kemi prezantuar me kërkesë për rishqyrtim.

Ne, nuk kemi kërkuar heqjen, ndryshimin apo modifikimin e ndonjë kriteri gjatë vlerësimit të tenderit, siç pretendon AK-së por kemi kërkuar që të merret parasysh ekuivalenca dhe të analizohet në substancë përbërja e produktit e jo vetëm aspekti sasior por aspekti cilësor dhe kualitativ.

Sa i përket ekuivalencës, OSHP-ja e ka lejuar ekuivalencën mirëpo autoriteti kontraktues nuk e ka përfill vendimin e OSHP-së, prandaj duhet të zbatohet edhe vendimi i OSHP-së dhe të merret parasysh përbërja ekuivalente e produktit që ne e kemi ofruar.

Pretendimi i AK-së, se nuk ka OE të favorizuar në këtë tender është i paqëndrueshëm sepse pikërisht grupi i OE BRT Pharm&NSHT Neramed është favorizuar me anulimin e këtij tenderi, pasi që i krijohet një mundësi ofertuese në të ardhmen, sepse tani në këtë aktivitet të prokurimit ky grup i OE ka qenë i papërgjegjshëm administrativisht.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se është vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri

kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me **çmimin më të ulët, sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.**

Nga faktet e lartcekura kuptohet se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, pasi që ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këtë dispozitë për anulim të tenderit.

Gjithashtu nuk është plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në nenin 43.5 dhe 43.7 i RRPP Nr.001/2022 për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, duke mos na rekomanduar për kontratë.*

Po ashtu nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Kërkojmë nga OSHP-ja që të mos caktojë eksperte teknike znj. Gëzime Pllana, pasi që e njëjta në secilën lëndë dhe ankesë që e kemi parashtruar dhe që ajo e ka shqyrtuar ka qenë e njëanshme dhe subjektive.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të marrë:

VENDIM

- I. APROVOHET**, e bazuar ankesa e OE **“MEDPLUS SH.P.K**
- II. ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-s.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

v10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të *“Njoftimit për Kontratë”* apo *“Njoftimit për Konkurs të Projektimit”*.
- b) një kopje të publikimit për *“Njoftimin e Dhënies së Kontratës”* apo *“Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”* apo *“Njoftimit për Anulim”*.

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*